



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr.139, datë 27.11.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 3 DATË 03.02.2017 “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS
KANALIZIME PATOS SH.A.”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”(VKM nr.958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 27.11.2020 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projekt vendimit për një ndryshim në vendimin e komisionit kombëtar rregullator nr. 3 datë 03.02.2017 “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Patos sh.a.”,

Vëren se:

1. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Patos (**UK Patos**) me shkresat nr. 189 prot. datë 05.11.2020 me lëndë “ Kërkesë për ndryshim të zonës së shërbimit UK Patos” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**), për ndryshim të zonës së shërbimit, dokumentacionin e nevojshëm mbi shkëputjen e njëjësive administrative Portez dhe Cakran të Bashkisë Fier që më parë shërbeheshin nga UK Patos.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të ndryshimit të zonës së shërbimit të UK Patos në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.

3. KKRR ka licencuar shoqërinë UK Patos me vendimin nr. 3, datë 03.02.2017 “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Patos sh.a.” me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe për zonën e shërbimit si më poshtë:

Bashkia: Patos

Bashkia: Fier Njësia administrative Portez, Cakran

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Patos është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

Në pikën 3 të vendimit të KKRR nr. 3, datë 03.02.2017 “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Patos sh.a.”, bëhen këto ndryshime:

Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Patos sh.a është Bashkia Patos.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Ndriçim Shani